



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:074843
Datë: 29.10.2024
Numri i dokumentit: 06366412

C.nr. 1898/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fatbardha Uka Ibrahim, në çështjen juridike të paditësit A.I., nga P., që sipas autorizimit e përfaqëson Klinaku & Associates, shoqëri e avokatëve nga Prishtina, kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensimi të shpenzimeve të ushqimit gjatë punës, jashtë seancës gjyqësore, me datë 29.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I.** APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.I., nga P., kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, në Prishtinë, ashtu që DETYROHET e paditura, që paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën nga data 18.04.2017 deri më datë 22.11.2022, për 1184 ditë të pranisë në punë, t'i paguaj në shumën e përgjithshme prej 2,368.00 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e parashtrimit të padisë, përkatësisht nga data 22.03.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- II.** DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 €, brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 22.03.2023 ka parashtruar padi në këtë gjykatë, për kompensim të shpenzimeve të ushqimit në punë. Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në vendin e punës si "...” në SHMLP "...” në Prishtinë. Ka shtuar se e paditura edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave që rrjedhin nga kontrata kolektive e arsimit e nënshkruar më datë 18.04.2017 dhe 22.01.2021, konform dispozitave të nenit 35 par. 5 dhe 7 i kësaj marrëveshje, paditësit nuk ia ka kompensuar shpenzimeve të ushqimit gjatë punës. Përmes parashtresës së datës 05.09.2024, paditësi përmes të autorizuarit të tij, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke i propozuar gjykatës që të dytrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë punës nga data

18.04.2017 deri më datë 22.11.2022, për 1184 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 2,368.00 €, me kamatë ligjore 8% nga data e parashtrimit të padisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata, me aktvendimin C.nr.1898/23 të datës 17.10.2023, e ka detyruar të paditurin që të përgjigjet në padi, nën paralajmërimin që nëse nuk parqet përgjigje në padi në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit të lartpërmendur, gjykata do të merr aktgjykim në bazë të pa dëgjueshmërisë/mosbindjes.

I padituri, edhe pse aktvendimin C.nr.1898/23 të datës 17.10.2023, të kësaj gjykate e ka pranuar me datë 26.10.2023, siç konstatohet nga fletëkthesa e dorëzuar me Postën e Kosovës, nuk ka parashtruar përgjigje në padi, andaj gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për të marrë aktgjykim për shkak të padegjueshmërisë/mosbindjes, bazuar në dispozitat ligjore të nenit 150 paragrafi 1 pikat a, b dhe c të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Gjykata, nga provat e bashkangjitura në padi, gjeti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, gjegjësisht në vendin e punës si "...” në SHMLP “.....”, ashtu që kjo vërtetohet sipas kontratës me të paditurën. Po ashtu, është vërtetuar se i njëjti për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më datë 22.11.2022 ka gjithsej 1184 ditë pune. Gjykata, faktet e tilla, i vërtetoi në bazë të kontratës së punës me nr.prot..., të datës 02.10.2018, si dhe vërtetimit nr. prot., të datës 02.09.2024.

Provave të lartcekura, gjykata u fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia e tyre provuese, kjo për arsyen se me dispozitën e nenit 329 par.1 të LPK-së, përcaktohet: *Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.*

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e dy Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021.

Me nenin 2 pika 1 të Kontratave Kolektive, parashihet që: “[d]ispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë) qendrat burimore në kuadër të MASH-it dhe qendrat e kompetencës në kuadër të AAAPARR). Shtëpitë e studentëve dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë antëtarë të SBASHK-ut”, dhe pika 1.2 “[d]ispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të universitetet, institucionet e arsimit të lartë, shtëpitë e studentëve, qendrat burimore në kuadër të MASH-it, qendrat e kompetencës, në kuadër të AAAPARR, MASH-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukative – arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”.

Në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratave Kolektive, parashihet se: *“të punësuarve , u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy (2) € për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”*, andaj bazuar në vërtetimin e datës 02.09.2024 është vërtetuar se paditësi për periudhën duke filluar nga data 18.04.2017 deri më datë 22.11.2022 ka gjithsej 1184 ditë pune dhe të njëjtit i takon e drejta në kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë punës dhe atë në shumë prej 2,368.00 €, e cila është përlllogaritur duke e shumëzuar ditës e punës me vlerën prej 2 euro.

Sipas dispozitës së nenit 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) parashihet se *“kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e kësaj dispozite ligjore dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’i kompensoi shumat e gjykuara, sipas pikës (I) të këtij aktgjykimi.

Së këndejmi, mbi bazën e të gjitha provave, gjendjes faktike të vërtetuar mbi bazën e këtyre provave, në pajtim me nenin 150.1 të LPK-së, përfundimisht gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe duhet të aprovohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së, sipas së cilit parashihet se *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata duke u bazuar në nenin 452 par 1 të LPK-së e ka obliguar të paditurën që paditësit t’i paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 20.00 euro.

Nga sa u theksua më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1898/23, datë 29.10.2024

Gjyqtarja
Fatbardha Uka Ibrahim

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.